



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER NIKOLETA P. GJORDENI
ADRESA MYSLYM SHYRI, NR.30
TEL: 696051791

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3448

Nr. koleksioni: 1209

Tirane më 30/08/2023



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29.07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10.03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023053100123724108





KONTRATË SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 20.08 2023 (dymijë e njëzetë e dy), përpara meje noteres publike **Nikoleta Gjordeni**, Anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me zyrë noteriale në rruga "Myslym Shyri", pall. 31, kati 2, Tiranë, u paraqitën personalisht palët:

SHITESI

MAILINDA ANGJELI, atësia Theodor, amësia Natasha, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Ymer Kurti; Nd. 8; H. 18; Ap. 34; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 05/05/1968, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034013754 dhe nr. personal G85505091U, ne cilesine e njerit prej ortakeve te "Hidro Vision" shpk, e cila zoteron 1 kuote e cila perben 50% te kapitalit themeltar te kesaj shoqërie, referuar në Kontratë, si "Shitësi".

VASIL ANGJELI, atësia Aristidh, amësia Aretija, shtetas Shqiptar, lindur në Sarandë dhe banues në TIRANË, me adresë Ymer Kurti; Nd. 8; H. 18; Ap. 34; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 04/03/1965, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036546861 dhe nr. personal G50304104J, ne cilesine e "Dhënesit te Pelqimit", si bashkeshorti i shitëses në këtë kontratë,

BLERESI

SHOQËRIA "HIDRO KONS STUDIO" SHPK, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L22412006A, me seli në Tirane, me adresë Numer Pasurie 176/1/Nd, Ne Zonen Kadastrale 2376, Rruga Ura E Beshirit, Lalm, Vaqar, Tirane, **PËRFAQËSUAR NGA ADMINISTRATORI, Silvana Shuaipi**, atësia Sofokli, amësia Rajmonda, shtetase Shqiptare, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, me adresë Z Jubani; Nd. 010; H. 1; Ap. Apt 5; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 23/11/1979, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035740784 dhe nr. personal H96123119B, referuar në Kontratë, si "Blerësi"

MIRATUESI

SHOQËRIA "HIDRO VIZION" SHPK, person juridik shqiptar, regjistruar ne QKB, me datë 03/06/2016, me NIPT L61803020D, me seli ne Tirane, Rruga e Kosovareve, Pallati Ndervepro, kati 4, shkalla 1, apa. nr.1, me Administrator, Daniel Shuaipi, ne cilesine e "Mbajtesit te Miratimit", sipas kontrates se nenshkruar me MIE-n, "Kontrate per Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Hidrocentralit "Razdoll", me kapacitet prodhues 0.700 MË, në Përroin e Razdollit, Degë e Lumit Osum, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë", nr. 2702 Rep, nr. 1275/3 Kol, datë 2 nentor 2017, para notere, Dhurata Vardhami.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "HIDRO VIZION" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:



A202305310012372410S

Kushtet Paraprake

Referuar të dhënave që rezultojnë nga Regjistri Tregtar në QKB, deri më datë 21.08.2023, rezulton se:

- 1- Shitësi, është ortak, zotërues i një kuote që përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë "Hidro Vizion" shpk, me vlere 50.000,00 leke (pesedhjetë mijë leke), person juridik shqiptar, regjistruar ne QKB, me datë 03/06/2016, me NIPT L61803020D, me seli ne Tirane, Rruga e Kosovareve, Pallati Ndervepro, kati 4, shkalla 1, apa. nr.1.
- 2- Shoqëria "Hidro Vizion" shpk, ne perputhje me legjislacion rregullator respektiv, ka nenshkruar me Ministrine e Infrastruktues dhe Energjitikes, "Kontrate per Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Hidrocentralit "Razdoli", me kapacitet prodhues 0.700 MË, në Përroin e Razdolit, Degë e Lumit Osum, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë", nr. 2702 Rep, nr. 1275/3 Kol, datë 2 nentor 2017, para notere, Dhurata Vardhami, dhe rrjedhimisht, ne kete kontrate, eshte ne cilesine e "Mbajtesit te Miratimit".
- 3- Shitesit dhe miratuesit ne kete kontrate, deklarojne se kane nenshkruar Akt marreveshjen nr. 34/4 rep, nr. 1188 kol, date 28.08.2023, para noteres Nikoleta Gjordeni Tirane, sipas se ciles Miratuesi ne kete kontrate eshte detyruar ti ktheje shitesit ne kete kontrate ne cilesine e kreditorit, vleren e kontributit prej 125 000 (njeqind e njetzet e pese mijë euro), menezhere pas nenshkrimit te aktmarreveshjes. .
- 4- Shitësi, dëshiron ti shesë Blerësit (qe eshte njekoheshst ortaku tjetër i shoqerise (HIDROVIZION), SHPK dhe Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi kuotën e zotëruar prej tij, e cila përbën 50 % të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë "Hidro Vizion" shpk.
- 5- Kalimi i kuotave të Kapitalit Themeltar, nëpërmjet shitjes tek Blerësi- SHOQËRIA "HIDRO KONS STUDIO" SHPK, është miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme së Ortakëve, bashkëngjitur kësaj Kontrate, në përputhje të plotë me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, palët, ranë dakord dhe kërkuan redaktimin e kësaj Kontratë Shitblerje Kuotash, me kushtet si më poshtë,

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate, është transferimi i pronësisë nëpërmjet shitjes, i kuotës së zotëruar prej Shitësit- MAILINDA ANGJELI, që përbën 50 % të Kapitalit Themeltar të "Hidro Vizion" shpk, tek Blerësi - SHOQËRIA "HIDRO KONS STUDIO" SHPK, dhe fitimi i pronësisë së plotë nga Blerësi, i kuotës që përbën 50% të Kapitalit Themeltar të "Hidro Vizion" shpk, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë, në dakortësi të plotë me njëri - tjetrin, në përputhje Statutin e Shoqërisë- "Hidro Vizion" shpk, me Ligjin, nr. 9901 date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjin, nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" dhe Ligjin, nr. 110/2018, "Për Noterinë".

Neni 2

CMIMI I SHITJES DHE MODALITETI I PESËS

- 2.1 Cmimi i shitjes së 1 kuote (një), të zotëruar prej MAILINDA ANGJELI, që përbën 50 % të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë "Hidro Vizion" shpk, është 125 , 000 euro (njeqind e njetzete e pese mijë euro), cmim per te cilin palet kane dakortesuar te paguhet duke filluar nga data e firmosjes se kesaj kontrate deri ne muajin gusht 2024 (ose e shrehur ndryshe ne nje afat kohor 12 mujor), per llogari te shitesit



A2023053100123724108

MAILINDA ANGJELI, ne numrin e llogarise bankare, prane bankes "B.K.T", sha. Pagesa i bashkelidhet kesaj kontrate si pjese e pandare e saj.

2.3 Palet, deklarojne se nuk kanë dhe nuk do te kenë asnjë lloj pretendimi në të ardhmen, të cfaredolloj natyre, lidhur me çmimin e shitjes dhe deklarojnë se ky është nje cmim i drejtë, real dhe i përcaktuar në dakortësi të plotë, ndërmjet tyre.

Neni 3 KALIMI I PRONËSISË

3.1 Shitësi MAILINDA ANGJELI dhe Blerësi SHOQËRIA "HIDRO KONS STUDIO" SHPK, deklarojnë se/dhe bien dakord se kjo Kontratë do të prodhojë efekte juridike mes palëve, pas pageses se plote te cmimit te shitjes se kuotes, brenda kohezgjatejes se percaktuar nen nenin 2, duke u rregjistruar ne QKB, dhe duke u njoftuar me shkrim e me pas duke u marre miratimi/dhenia e pelqimit, ME SHKRIM, NGA MINISTERIA E INFRASTRUKTUES DHE ENERGJISË ("MIE"/AUTORITETI KONTRAKTUES, për kalimin e 1 kuote (një) që përbën 50 % të kuotave të kapitalit të Mbajtesit te Miratimit "Hidro Vision" shpk, në emër të blerësit të ri të kuotave- shoqeria "Hidro kons studio" shpk, ne bazë dhe për zbatim të detyrimeve kontraktuale (Neni 15, kufizimet) që rrjedhin nga "Kontrate per Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Hidrocentralit "Razdoli", me kapacitet prodhues 0.700 MË, në Përroin e Razdolit, Degë e Lumit Osum, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë", nr. 2702 Rep, nr. 1275/3 Kol, datë 2 nentor 2017, para notere, Dhurata Vardhami dhe detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni rregullues mbi sektorin e energjitikës në përgjithësi.

3.2 SHOQËRIA KONCENSIONARE "HIDRO VIZION" SHPK, me NIPT L61803020D, bie dakord dhe merr persipër detyrimin se menjëhere, pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, do të depozitohë, "Kërkesën për Marrjen e Miratimit Paraprak me Shkrim, në "MIE";

Blerësi, deklaron se do të angazhohet maksimalisht, për vënien në dispozicion të Shitësit, të cdo dokumentacioni, që duhet të vihet në dispozicion prej tij, në bazë dhe zbatim të legjislacionit në fuqi.

3.3 Shitësi dhe Blerësi, deklarojne se menjehere pasi te kaloje pagesa e cmimit te shitjes, sipas modalitetit te percaktuar ne nenin 2 te Kontrates, ai dhe pas permbushjes se detyrimit per kthimin e kontributit te ortakut sipas nenshkruar Akt marreveshjes nr. 3474 rep, nr. 1182 kol, date 28.08.2023, para noteres Nikoleta Gjordeni Tirane, te vertetura keto me transfertat bankare, kjo Kontrate, do te depozitohet ne QKB, per pasqyrimin ne ekstraktin tregtar te shoqerise- "Hidro Vizion" shpk, të kalimit të pronësisë se kuotave, tek bleresi i ri, shoqeria "Hidro kons Studio" shpk.

3.4 Palët konfirmojnë se struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë "Hidro Vizion" shpk, me përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate, do të jetë si vijon:

- a) Shoqëria "HIDRO KONS STUDIO shpk, ortake e vetme dhe zotëruese e plote e nje kuote që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë "Hidro Vizion" shpk.

3.5 Me përmbushjen e kushtit të kësaj kontrate, bleresit SHOQËRIA "HIDRO KONS STUDIO" SHPK - në cilësinë e ortakut të ri te vetem , me pronësi, të 1 kuote (një) që përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë "Hidro Vizion" shpk, i kalojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kësaj kuote, përfshirë por pa u kufizuar në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga "Kontrate per Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Hidrocentralit "Razdoli", me kapacitet prodhues 0.700 MË, në Përroin e Razdolit, Degë e Lumit Osum, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë", nr. 2702 Rep, nr. 1275/3 Kol, datë 2 nentor 2017, para notere, Dhurata Vardhami".



A2023053100123724108

Neni 4
HEQJE DORE NGA TE DREJTAT

4.2 Shitësi MAILINDA ANGJELI, deklaron nën përgjegjësinë e saj personale se heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë në cilësinë e ortakut të shoqërisë "Hidro Vizion" SHPK, mbi kuotën e zotëruar prej saj, që përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë dhe pjesës së zotëruar prej saj, me vlerë të përgjithshme 50, 000 lekë (pesedhete mijë leke), që transferohet te Blerësi, SHOQËRIA "HIDRO KONS STUDIO" SHPK dhe te gjitha të drejtat dhe detyrimet i kalojne blerësit të ri, pas përmbushjes së kushtit të kësaj kontrate.

Neni 5
GARANCITË

5.1 Shitësi dhe Miratuesi- "Hidro Vizion" shpk, deklarojnë dhe garantojnë blerësin se:

- Shoqëria "Hidro Vizion" shpk, ekziston në mënyrë të ligjshme dhe kryen veprimtarinë e saj tregtare, sipas objektit të deklaruar.
- Shitësi është zotëruar i vetëm i kuotës dhe gëzon të gjitha të drejtat e votës dhe cdo të drejtë tjetër që rrjedh nga Kuota dhe ka tra të plota për të shitur Kuotën e zotëruar prej tij. Kuota është lirisht e transferueshme dhe asnjë miratim tjetër nuk nevojitet për realizimin e kalimit të kësaj kuote tek pala blerëse.
- Shitësi, deklaron dhe garanton blerësin se, kuota është e lire nga cdo lloj pengu, detyrimi, takse, pretendimi nga te tretë, te drejtë parablerjeje, barrë tjetër mbi kuotën apo detyrim që rrjedh nga një proces gjyqësor, aktual apo i ardhshëm. Nga verifikimi i Regjistrimit të Barrëve Siguruese, Kuota rezulton të jetë e lirë dhe e pa barrësuar.
- Shitësi dhe Miratuesi "Hidro Vizion" shpk deklarojnë me përgjegjësi të plotë se nuk kanë ndonjë detyrim kontraktual apo të ndonjë natyre tjetër karshi të tretëve dhe se per cdo detyrim tjetër eventual, që rezulton para nënshkrimit të kësaj kontrate apo pas nënshkrimit të saj, për të cilat, blerësi nuk ka dijeni dhe detyrimi nuk është i përfshirë/faktuar në dokumentacionin bashkëngjitur kesaj Kontrate apo i paparashikuar në këtë kontratë, **do të përgjigjet MIRATUESI "HIDROVIZION" shpk, pa kufizim, pa cënuar në asnjë formë dhe mënyrë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë, të drejtat e fituara nga blerësi, nëpërmjet kësaj Kontrate, të 1 kuote (një) që përbën 50 % të kapitalit të Mbajtesit te Miratimit;**
- *Shitësi, deklaron se merr përsipër detyrimin dhe garanton Blerësin, mbi pronësinë e plotë dhe të ligjshme mbi kuotën dhe se në rast se ndonjë palë e tretë, do të ngrejë pretendime në lidhje me të drejtat e pronësisë apo të drejtave të tjera mbi kuotën, shitësi, merr përsipër të përgjigjet personalisht- vetëm si individ-ish ortak-shites, pa cënuar të drejtat e fituara nga blerësi nëpërmjet kësaj kontrate dhe të garantojë mosçënimin e të drejtave të pronësisë së Blerësit të ri dhe të garantojë që pronësia e Blerësit mbi Kuotën dhe të drejtat e tjera mbi të, të mos çënohen në asnjë formë apo masë. Blerësi, fiton të drejtat e plota dhe të pakufizuara të pronësisë mbi Kuotën, sipas kësaj Kontrate.*
- *Shitësi DHE Miratuesi, deklarojnë se nuk do të ndërmarrin përsiper asnjë detyrim/angazhim kontraktual apo të kryejnë çfarëdo transaksioni me pjesën takuese të kuotes, objekt i kësaj kontrate dhe/ ose pas nënshkrimit të kësaj kontrate, nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate dhe deri kur Blerësi, të rezultojë ortak -objekt i kesaj kontrate;*
- *Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe përmbushjen e kushtit të kësaj kontrate, Blerësit, i transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas Kontrates se referuar ne krye te kesaj kontrate, prej se ciles „Hidro Vizion“ eshte pajisur me Miratimin per Ndertimin e Hec-it;*
- Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim, me ligjet, Statutin, Kontratat, apo marrëveshjet e tjera në të cilat, shitësi është palë.



A2023053100123724108

- Shitësi dhe Miratuesi, deklarojnë me përgjegjësi të plotë ligjore, se cdo dokument, bashkëngjitur kësaj Kontrate, është i ligjshëm dhe i vërtetë dhe në rast të ndonjë pretendimi, për pavërtetësinë apo paligjshmërinë e ndonjë dokumenti, Shitësi, do të jetë përgjegjësi i vetëm, i cili do të përgjigjet ndaj çdo pretendimi të të tretëve;
- Shitësi dhe Miratuesi, deklarojnë me përgjegjësi të plotë ligjore-personale se cdo deklarim dhe garanci e dhënë sipas kësaj Kontrate, është i vërtetë, i saktë dhe nuk përmban të dhëna të rrema apo janë në mashtrim të palës bblereë.

5.2 Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:

- a) Blerësi ka tra të plota për të blerë Kuotën, sipas kushteve dhe afateve të dakortësuara në këtë Kontratë.
- b) Blerësi deklaron se paraprakisht ka verifikuar gjendjen financiare dhe kontabile të shoqërisë dhe ka dijeni të plotë në lidhje me detyrimet dhe gjendjen e saj financiare dhe deklaron se njeh dhe pranon të blejë Kuotat, sipas Kushteve të kësaj Kontrate, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka në përpjestim me përqindjen e kuotes që përfiton;
- c) Blerësi, deklaron se do të përmbushë rigorozisht, detyrimin e pimit të cmimit total të shitjes, sipas dakortësisë dhe modalitetit të përcaktuar në këtë Kontratë.
- d) Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim, me ligjet, Statutin, Kontratat, apo marrëveshjet e tjera në të cilat, blerësi, është palë.
- e) Blerësi, deklaron me përgjegjësi të plotë ligjore-personale se cdo deklarim dhe garanci e dhënë sipas kësaj Kontrate, është i vërtetë, i saktë dhe nuk përmban të dhëna të pasakta.

Neni 6 TË NDRYSHME

- a) 6.1 Pas realizimit të këtij transferimi nëpërmjet shitjes së kuotave, me përmbushjen e kushteve të kësaj kontrate, blerësi "Hidro Kons Studio" shpk, , bëhet ortak i vetëm /zotëruar i nje kuote që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë "Hidro Vizion" shpk.

6.2 Dokumentat bashkëngjitur kësaj Kontrate, janë:

- b) Vendim i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë, "Hidro Vizion" shpk, "Hidro Kons Studio" shpk.
- c) Ekstrakti Tregtar i shoqërisë, "Hidro Vizion" shpk dhe "Hidro Kons Studio" shpk/ ID e Administratorëve.
- d) Vërtetim nga Shërbimi Përmbartimor Shtetëror;
- e) Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për subjektin tatimpues- "Hidro Vizion" shpk;
- f) Kopje e Kontratës së Konkensionit;
- g) Kopje e cdo akt administrativ qe disponon "Hidro Vizion" shpk;
- h) Bilancet e Tre Viteve te Fundit;

6.3 Palët, zotohen dhe marrin përsipër bashkërisht, detyrimin për të trajtuar dhe ruajtur si konfidenciale dokumentacionin dhe të dhënat e përfituara nga krijimi i kësaj marrëdhënieje juridike, për palë të treta.

6.4 Kjo Kontratë, pas nënshkrimit të saj, do të depozitohet në QKB, për pasqyrimin në regjistrin tregtar të "Hidro Vizion" shpk, të kalimit të kuotave tek ortaku i ri, pranë Institucioneve bankare perkatese, për kalimin e cmimit të shitjes, në llogarinë bankare të shitesit shpk dhe shlyerjen e detyrimeve (neni 2 i Kontrates), si dhe cdo Institucion tjetër, për efekt njoftimi të ndryshimit të ortakëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi pra pranë Institucioneve të "MIE-s".



A2023053100123724108

**Neni 7
DISPOZITA TË FUNDIT**

7.1 Kjo Kontratë, përmban marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve në lidhje me objektin e përcaktuar në këtë Kontratë dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, ndërmjet palëve, me gojë apo më shkrim, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

7.2 Në rast të mospërmbushjes së kushtit të kësaj Kontrate, palët, bien dakord se kjo kontratë, do të konsiderohet automatikisht e zgjidhur dhe palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme duke kaluar automatikisht në procesin e auditimit financiar për sistemin e kuotave sipas kontributeve të secilit ortak.

7.3 Kjo Kontratë, do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit, nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (i ndryshuar) dhe nenet 705 e vijues të KCRSH.

7.4 Cdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Palët morën dijeni se të dhënat e tyre personale, unë noterja do t'i përdor në zbatim të ligjit vetëm për efekt të redaktimit të këtij akti. Përpunimi i këtyre të dhënave do të bëhet prej meje vetëm në respektim të plotë dhe zbatimin rigoroz të dispozitave të ligjit 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Kjo kontratë u hartua në pesë ekzemplare me vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nën për nen, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tyre origjinal.

Palet deklaruan se janë dakort me sa me sipër, dhe pasi e lexuan, e kuptuan, e nënshkruan rregullisht përpara meje dhe unë noterja, e vertetoj atë sipas ligjit.

SHITËSI

BLERËSI

MAILINDA ANGJELI

VASIL ANGJELI

SHOQËRIA "HIDRO KONS STUDIO" SHPK



PERFAQESUAR NGA SILVANA SHUAJPI

NOTERE

NIKOLETA GJORDENI

